



Parku Industrial Mitrovicë,
Republika e Kosovës, Mitrovicë, 40000

Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/ Nr. 36 / 31 tetor 2016), të nenit 23 paragrafi 4, të Statutit të Trepça Sh.A, të nenit 17 dhe 21 paragrafët 1, 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, (G Z / Nr. 31/15 qershor), Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. pas përfundimit të procesit të intervistimit me gojë të kandidatëve më datë 22.07.2019, merr këtë:

VENDIM

- I. Me të cilin, në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe i Thesarit të Trepça Sh.A. përzgjidhet z. Fahredin Berisha;
- II. Mandati i kandidatit nga pika I, fillon nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Bordit Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. pas vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve të paraqitur, dhe pas fazës së intervistimit për kandidatët të cilët janë thirrur në listën e ngushtë, duke u bazuar në kriteret ligjore të bëra publike edhe me konkursin e datës 06.06.2019 për Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit të Trepça Sh.A, në bazë të vlerësimit të të gjitha komponentëve dhe me qëllim të zbatimit të parimit të meritokracisë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës



Ardian Syla

Ky Vendim i dorëzohet:

- a) Të përmendurit;
- b) Anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës;
- c) Sekretarit të Trepça Sh.A;
- d) Arkivit të Trepça Sh.A.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimit të vendimit.